

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: FV NDRICIM RRUGA "BAJRAM TUSHA", L.14 SHKOZET

SPECIFIKIME TEKNIKE (Ndricim rrugor)

Ne kete segment rrugor do te behet investimi i ri i ndricimit rrugor duke ndryshuar gjithe ndricuesit duke i kthyer ne LED dhe zvendesuar shtyllat e ndricimit atje ku mungojne dhe jane te demtuara dhe do te zvendesohen me te reja.. Ndricimi i kasaj rruge do te behet ne te dy krahet.

Gjendja ekzistuese










Ky investim ne kete segment do te kete ndertim te ri te rrjetit te ndricimit rrugor ne nje distance prej 2000 ml per rrugen “Bajram Tusha”.

Ne kete investim do te behet infrastruktura nentokesore per 88 shtyllat e ndricimit qe konsiston ne betonime per 13 shtylla te reja ndricimi pasi pjesa tjeter jane eksistuese, do te vendosen 176 ndricues LED, do vendosen dhe 25 puseta plastike 30x30x30 ne nje trup te vetem. Puseta do te betonohet pas shtylles, ne shtrimin e tubit fleksibel Ø80 ne nje kanal 40cm te thell, i mbuluar me shtrese rere 10cm, sipas kushteve teknike te zbatimit.. Kalimi i tubit fleksibel nga trotuari ne trotuar ne stresat asfaltike do te behet ne tub celiku me $d=140\text{mm}$. (shiko detajet e projektit).

Do te behet dhe vendosja e 13 shtyllave 9m me spesor 3-4mm. Shtylla me ndricues rrugor Led 90-120 W 15300-20400 Lm, skeda Led, me lente asimetrike rrugore me guarnicion silikoni për temperaturë mbi 200° e montuar në një trup njësi alumini me ftohës në form grile për shkëmbim temperature . me shkallë mbrojtje IP65 , trupi ndricuesit alumin i anodizuar i lyster me bojë elektrostatische RAL 9022. jetegjatesi 100.000 ore pune.



Ndriçues rrugor Led 90-120 W 15300-20400 Lm, skeda Led, me lente asimetrike rrugore me guarnicion silikoni për temperturë mbi 200° e montuar në një trup njësi alumini me ftohës në form grile për shkëmbim temperature . me shkallë mbrojtje IP65 , trupi ndriçuesit alumini i anodizuar i lyer me bojë elektrostatische RAL 9022.



Shtyll cilindrike dekorative H-12.8m, çeliku i zinguar ne te nxehte dhe e lyer me bojë elektrostatische me shkalle mbrojtjeje IP 66 + . 5 Ndriçues jo me te vogel se 100w,15300lm per ndriçues,4000-5000k, Ndriçuesi do te perdoret ne rretherrrotullim, e kompletuar me te gjithë elementet dhe aksesoret.TIPI 2.

Kablllo fleksibël (me disa percjellsa shumëfijësh për çdo percjelles)

Të gjitha kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve përkatëse dhe çertifikatën e prodhuesit. Izolimi PVC i kablllove duhet të durojë 600/1000 V, të jete shumëfijësh me përçues të thjeshtë prej bakri të temperuar, të izoluara me PVC dhe me një shtrese PVC përfundimtare. Kabllot fleksibël të parashikuara në projekt përbehen nga percjelles shumëfijësh:

- Kablllo me 3 percjelles, 1 fazë, 1 nul, 1 tokezimi (për sistemin njëfazor)
- Kablllo me 4 percjelles, 3 fazë, 1 nul, (për sistemin trefazor)
- Kablllo me 5 percjelles, 3 fazë, 1 nul, 1 tokezimi (për sistemin trefazor)

Kabllot fleksibël duhet të kenë percjellesat të ngjyrosura për identifikim. Ngjyra blu duhet të përdoret për percjellsat e nullo, jeshile/verdhe duhet të përdoren për percjellsat e tokezimit, dhe ngjyra e kuqe, kafe, zeze ose gri për percjellsat e fazes. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Të gjitha materialet do të vendoset vetëm me pelqimin e supervizorit dhe të investitorit duke përdorur fletën e katalogut të certifikuar nga Komuniteti Europian.

Linja kryesore e furnizimit të shtyllave do të jete 5x 6 mm² me neuter të perseritur e futurë në tubin fleksibel në një kanal 40cm të thell. (shiko detajet e projektit).

ndersa çdo ndricues do të ketë kabell 3x2.5 mm².

Çdo shtyllë do të ketë puseten e tij me kapak të fort plastik me permasa 40 x40 x40

Puseta do të betonohet pas shtyllës.

Tokezimi I shtyllave do të realizohet nëpërmjet shufrave të tokezimit që do të vendosen në çdo shtyllë brenda në pusete. Tokezimi do të realizohet me neuter të perseritur.

Do te respektohen te gjitha specifikimet qe shoqerojne zerat e preventivit. Furnizimi me energji do te behet nga kabina me e afert e OSHEE deri tek boksi i komandimit me 4x10 mm² dhe do te caktohet qe ne fillim te punimeve ne menyre qe te vendoset per intersektimet e rruges.

Boksi i komandimit do te jete i paisur komplet si tregohet ne skemen qe eshte pjese e projektit. Do te kete dhe nje dalje per linje rezerve. shiko projektin.

Shiriti i sinjalizimit do te behet pergjate gjithe linjes, dhe do te vendoset 15cm poshte asfaltit ose trotuarit, dhe do te respektohen te gjitha zerat e preventivit.

FURNIZIMI ME ENERGJI NGA RRJETI (OSHEE)

Furnizimi me energji do te behet nga nje stacion i afert i kompanise elektro- energjitike lokale OSHEE. Stacioni me i Afert i furnizimit me Energji do te percaktohet si pike lidhjeje nga OSHEE. Momentalish eshte menduar Furnizimi nga 3 kabinat qe ndodhen me afer objektit. Pavaresisht kesaj, Investitori do ti referohet pikes se lidhjes qe do ti jepet nga Operatori i Energjise dhe ne baze te kesaj Nenkontraktori i punimeve Elektrike duhet te ribeje llogaritjet e seksioneve te kablllove furnizues te objektit dhe tja paraqese per miratim investitorit si ne gjatesi ashtu dhe ne seksion te percjellesave.

Matja e konsumit te energjise

Konsumi energjise matet ne tension te Ulet. Konsumi total i energjise eshte vendosur te behet ne panelin kryesor te tensionit te ulet.

Shtylla metalike celik S235 JR e lyer me boje elektrostatische, H=9m,D=90mm, d=60mm S=3-4mm ,

MODELI I SHTYLLES MARE SI REFERENCE:



Sipermarresi do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Sipermarresi do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

Shkatërrimi dhe heqja e strukturave, mbetjeve ekzistuese etj, nga Sipërmarrësi do të kryhet brenda vendit të punimeve siç udhëzohet nga Supervizori i objektit dhe siç tregohet tek vizatimet. Të gjitha materialet me vlerë ripërdorimi nga puna e çmontimit janë dhe do të mbeten pronë e Bashkisë. Sipërmarrësi do ti dorëzojë ato në vendin e caktuar nga Bashkia me shpenzimet e tij. Tërë mbeturinat e dala nga prishjet dhe shkatërrimi do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia. Sipërmarrësi do të jetë totalisht përgjegjës për heqjen dhe hedhjen në përputhje



me ligjet e shtetit, planit të menaxhimit mjedisor dhe kërkesave të këtij specifikimi, të të gjithë materialeve që dalin nga shkatërrimet.

Ne perfundim te punimeve do te leshohet Deklarata e Instalimeve dhe protokolli i tokezimit nga Inxhinieri juaj elektrik i licensuar.

Specifikoi:

Adnand Tocila

Mariglen Jahollari